



Lajmërim

Aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale

Viti shkollor 2017-2018

Në zbatim të Urdhërit Nr.336, datë 14.07.2011 “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, ju informojme se : *Dokumentacioni për aplikimin e zhvillimit të praktikës profesionale për vitin shkollor 2017 – 2018, do të paraqitet me zarf të mbyllur pranë sekretarisë së Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë, nga data 04.09.2017 - 08.09.2017 ora 08:00 - 16:30 dhe ditën e premte nga ora 08:00 - 14:00.*

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë detyrimisht të gjithë kandidatët që dëshirojnë të kryejnë praktikën profesionale do të jetë :

1. Kërkesë për zhvillimin e praktikës profesionale pranë DART (sipas shtojcës 5 “Formati i aplikimit”, bashkëlidhur “Rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”). Format i këtij dokumenti është në adresën zyrtare: dartiraneqytet.edu.al, rubrika Praktika Profesionale.
2. CV e praktikantit.
3. Fotokopje e noterizuar e dokumentit të identifikimit.

4. Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të studimeve universitare të ciklit të parë (Bachelor).
5. Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të studimeve universitare të ciklit të dytë “Master Shkencor” dhe /ose “Master profesional” në mësuesi.
6. Raport mjeko-ligjor.
7. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale.
8. Dokument i vendbanimit (apikantët duhet të jenë banor i qytetit të Tiranës).

Mungesa apo parregullsia në dorëzimin e një dokumenti sjell skualifikimin e aplikantit.

- Lista e IAPP ku praktikanti do të fillojë praktikën profesionale shpallet në ambientet e DART si dhe në adresën zyrtare: dartiraneqytet.edu.al, rubrika Praktika Profesionale.

Faleminderit!